



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 84-të, të mbajtur më 31.03.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-3705/1 të datës 13.04.2022, me pretendime për paligjshmëri në procedurën e zbatuar për furnizime publike nga ana e NP „-----“ -----, **HIDHET POSHT.**

Lënda me numër 12-3705/1 të datës 13.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës për arsye se denoncimi nuk përmban pohime të qarta apo sugjerime për paligjshmëri apo veprime të palejuara të personave zyrtar të personave zyrtar gjat kryerjes së autorizime dhe detyrave zyrtare.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 13.04.2022 është dorëzuar denoncim me pohime për paligjshmëri në procedurën e zbatuar për furnizime publike nga ana e NP „-----“ -----, dhe është formuar lënda me numër 12-3705/1 të datës 13.04.2022.

Në denoncim, parashtruesi shpreh dyshimin për njëanshmëri në procedurën e prokurimit publik të shërbimeve - mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve me blerjen e auto pjesëve sipas njoftimit nr.01646/2022, datë 10.02.2022, e arritur përmes llojit të specifikuar të procedurës dhe duke vendosur një pjesë të kriterëve në shpallje, me çka janë shkelur parimet e Ligjit për Prokurimin Publik. Parashtruesi konsideron se prokurimi ishte përcaktuar në mënyrë të papërshtatshme si i pandashëm dhe se kërkesa për dorëzimin e certifikatave ISO brenda procedurës ishte e pakuptimtë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se pretendimet e paraqitura në lëndë nuk tregojnë për veprime konkrete korruptive, pas së cilës ka gjykuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse denoncimi nuk përmban pretendime të qarta ose indikacione për veprime të kundërligjshme ose të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pėrpiloi: A.R.M.

Miratoi: K.N., anėtar i KSPK-sė

**KOMISIONI SHTETĒRORĒ
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Nėnkryetar
Katica Nikolovska

